



Planuar / Dorezuar Puniljeno/Prodato Received/Delivery	09.10.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM SHK	6471/2023		119



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

A.Nr.1111/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1111/2023, të datës 24.08.2023, të parashtruar nga ankuesja , nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike „ Kompensim material“, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafin 1.1; nenin 16. paragrafin 3 dhe nenin 1,8 paragrafin 1, nën paragrafin 1.5; të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 09.10.2023, njezëri mori këtë:

**V E N D I M**

**Përfundon Procedimi Administrativ** i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.1111/2023, të datës 24.08.2023, të parashtruar nga ankuesja

**A r s y e t i m**

Nëpunësja civile ( këtu e tutje vetëm ankuesja), më datë 24.08.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën A.nr.1111/2023, e plotësuar me datë 14.09.202, përmes parashtrësës me numër protokollit 1111/2023, për shkak të moszbatimit të vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, Vendimit me numër 14-020/02-174681/22, të datës 25.07.2022, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, dhe heshtjes administrative ndaj kërkesës së ankueses të datës 24.05.2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme vetëm Këshilli) në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 30.08.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Prishtinës, ndërsa ,kjo e fundit ,më datë 02.10.2023, ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat referuar kësaj çështje



juridiko-administrative.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:* Ankesën me numër të protokollit 5799/2023 të datës 24.08.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën e ankueses me numër 14-016/01-167568/22/1 të datës 18.07.2022; Kërkesën e ankueses me numër 14-030/01-103818/23/1/2/3/4/5 të datës 24.05.2023; Formularin për kërkesë apo ankesë të datës 06.10.2022; Kërkesën e ankueses të datës 04.10.2022; Komunikimin elektronik të datës 25.05.2023, 26.05.2023 lidhur me lëndën e ankueses; Kopjen e letër njoftimit të ankueses; Vendimin me numër A.nr.486/2022 të datës 27.06.2022 të KPMSHCK-së; Aktgjykimin me numër AA.nr.639/2020 të datës 19.04.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës; Vendimin me numër 14-020/05-202856/22 të datës 23.08.2022; Akt emërimit e ankueses AE.Nr.01-112-841 të datës 01.08.2022; Akt emërimit e ankueses me numër 01-112-990 të datës 11.12.2012; Vendimin me numër 01 nr.112-157 të datës 28.01.2010; Letër konfirmimit e datës 16.07.2020; Plotësimin e ankesës së ankueses me numër protokollit 1111/2023 të datës 14.09.2023 në KPMSHCK; Kërkesën e ankueses të datës 28.08.2023; Formularin për kërkesë apo ankesë të datës 30.08.2023; Komunikimin elektronik të datës 22.10.2022, 15.10.2022, 12.10.2022, 17.10.2022, 11.02.2023, 16.03.2023, 11.02.2023, 16.08.2023, 16.03.2023, 11.02.2023 lidhur me lëndën e ankueses; Kërkesën e datës 09.02.2023 për pagesë të pagave dhe kontributeve për nëpunësit publik të kthyer në punë; Vendimin me numër 14-020/04-90644/22 të datës 26.04.2022; Konstatimin e datës 04.02.2023; Formularin mbi të dhënat për pagesë retroaktive të muajit shkurt 2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 30.08.2023 nga KPMSHCK-ja; Përgjigjen në ankesë të datës 02.10.2023 nga Komuna e Prishtinës së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Komunikimin elektronik të datës 28.09.2023, 16.08.2023 lidhur me lëndën e ankueses; Vendimin me numër 14-101/03-0271157/22 të datës 19.12.2022; Aktgjykimin me numër PAKR.nr.248/2022 të datës 15.11.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti i Krimeve të Rënda; Aktgjykimin me numër PKR.nr.147/2021 të datës 27.04.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Krimeve të Rënda; Llogaritjet për listën e pagave për vitin 2020, 2021, 2022 për G.TH së bashku me formularin për kërkesë lidhur me pagesën retroaktive të muajit shkurt ; Vendimin me numër 14-101-03-273524/22 të datës 21.12.2022; Aktgjykimin me numër PKR.nr.13/18 të datës 20.10.2022 Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Krimeve të Rënda; Vendimin me numër 14-020/04-90644/22 të datës 26.04.2022; Llogaritjet për listën e pagave për vitin 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022 për G.F së bashku me formularin për kërkesë lidhur me pagesën retroaktive të muajit shkurt 2023; Vendimin me numër 14-101/03-2555/23 të datës 05.01.2023; Vendimin me numër A.nr.727/2021 të datës 24.11.2022 nga KPMSHCK-ja; Vendimin 14-020/04-90644/22 të datës 26.04.2022; Llogaritjet për listën e pagave për vitin 2020, 2021 dhe 2022 për G.I së bashku me formularin për kërkesë lidhur me pagesën retroaktive të muajit shkurt 2023; Llogaritjet për listën e pagave për vitin 2015, 2016, 2017, 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022 për ankuesen; Komunikimin elektronik të datës 04.10.2023, 25.09.2023; Listën e pagave për ankuesen, emalin e datës 28.07.2022 të Njësisë së Personelit të Komunës së Prishtinës, lidhur me zbatimin e Vendimit të Këshillit A.nr.486/2022, Vendimin me numër 14-020/02-174681/22, të datës 25.07.2022, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi që përfundon procedimi



administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.1111/2023 të datës 24.08.2023, e parashtruar nga ankuesja *sepse:*

Nga administrimi i shkresave të lëndës Kolegji ka gjetur se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Aktgjykimin me numër AA.nr.639/2020 të datës 19.04.2022 të Gjykatës së Apelit-Departamenti për Çështje Administrative, me datë 27.06.2022 ka nxjerrë Vendimin me numër A.nr.486/2022, me të cilin është aprovuar ankesa e ankueses e datës 02.02.2015, është anuluar Vendimi Nr.01.007-288464, i datës 27.01.2015, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, Vendimi me numër 116-261616, i datës 19.12.2014, i Komisionit Disiplinor të Komunës së Prishtinës si dhe Akt emërimi me numër 01-112-990 i datës 24.07.2014, duke e obliguar Kryetarin e Komunës së Prishtinës, për kthimin e ankueses në vendin e punës sipas Akt emërimit të datës 11.12.2012, në pozitën si Zyrtare e lartë për politika të planifikimit dhe të ndërtimit urban, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet, nga marrëdhënia e punës si dhe të bëjë kompensimin e të gjitha pagave të ankueses nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Me datë 29.07.2022, Komuna e Prishtinës, në këtë rast Njësia e Personelit, me datë 28.07.2022 ka njoftuar Këshillin lidhur me zbatimin e Vendimit A.nr.486/2022, të datës 27.06.2022, duke përcjell si dëshmi Vendimin me numër 14-020/02-174681/22, të datës 25.07.2022, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, me të cilin në pikën I të dispozitivit është vendosur që ankuesja të kthehet në pozitën e punës Zyrtare e lartë për politika të planifikimit dhe të ndërtimit urban, ndërsa sipas pikës II të dispozitivit, është përcaktuar që ankueses ti njihen të gjitha të drejtat në përputhje me Vendimin e Këshillit A.nr.468/2022 të datës 27.06.2022.

Ankuesja me datë 24.08.2023, parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, për shkak të moszbatimit të vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, Vendimit me numër 14-020/02-174681/22, të datës 25.07.2022, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, dhe heshtjes administrative ndaj kërkesës së ankueses të datës 24.05.2023, duke kërkuar kompensimin material të të gjitha pagave dhe atë në mënyrë retroaktive nga data 19.12.2014 e deri në ditën e kthimit në vendin e saj të punës përfshirë edhe kontributet pensionale si dhe pagesën e detyrimeve tatimore.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në rrethanat si më lartë, vlerëson se objekti i ankesës së datës 24.08.2023, është i njëjtë me objektin e ankesës së ankueses të datës 02.02.2015, për të cilin Këshilli kishte vendosur në mënyrë meritore përmes Vendimit A.nr.486/2022 të datës 27.06.2022, gjegjësisht, ankuesja përmes ankesës së datës 24.08.2023, kërkon kompensimin e pagave në mënyrë retroaktive nga ndërprerja e marrëdhënies së punës ( 19.12.2014) e deri në kthimin e saj, duke përfshirë pagesën e kontributeve pensionale dhe detyrimeve tatimore, e për të cilat të drejta dhe detyrime Këshilli ka vendosur meritorisht me Vendimin A.nr.486/2022, të datës 27.06.2022. Andaj, në kuptim të dispozitave të nenit 101, paragrafit 1, nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Një organ publik përfundon një procedurë administrative, në cilëndo fazë të saj, nëse zbulon se: gjatë më pak se dy (2) viteve para datës së parashtrimin të kërkesës, ka vendosur për të njëjtën kërkesë të paraqitur nga pala e njëjtë, me të njëjtin qëllim dhe bazuar mbi të njëjtën situatë faktikë.."* Kolegji vlerësoj që janë plotësuar kërkesat ligjore për përfundim të procedurës administrative të





filluar sipas ankesës me numër A.nr.1111/2023 të datës 24.08.2023 të parashtruar nga ankuesja

Kolegji i Këshillit, lidhur me moszbatimin e vendimeve të Këshillit, rithekson faktin së në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit, pala ka të drejtën e ndërmarrjes së veprimeve siç përcaktohet me nenin 23 paragrafin 7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Bazuar në konstatimet si me sipër, Kolegji i Këshillit referuar dispozitave të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenin 101 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1111/2023

Ardita Perçuku-Shyti



Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi



Kryetare e Kolegjit



### Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës dhe
- Arkivoit të KPMSHCK-së.

